

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL, Gjyqtari i vetëm gjykues, Gazmend Bahtiri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.U.nga fshati O. Komuna e P., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së, sipas aktakuzës PP.nr.1693-12/07 të datës 05.11.2008, dhe ndaj të miturit G. F. nga P. rruga “...” pn. për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par. 1 të KPK-së, dhe propozimit për shqiptimin e masës edukuese mbikëqyrja e shtuar nga organi i kujdestarisë, të PPK, në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPM.nr.184-12/2007, të datës 05.11.2008, pas përfundimit të shqyrtimeve gjyqësore publik me datë 20.11.2015, në praninë e Përfaqësuesit të Prokurorisë të Shtetit Fatmir Behrami, dhe të akuzuarit, me datë 23.11.2015, mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, ndërsa me datë 21.12.2015 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B.U., me nofkat, C. dhe Ç., i biri i S. dhe nënës R. e vajzërisë H., i lindur më *data e lindjes...*, me vendbanim në fshatin O., Komuna e P., me nr. personal: *numër personal...*, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion ndërtimtar, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, më parë ka qenë i gjykuar, nuk ka të dhëna se zhvillohet procedurë tjetër penale, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në natën e në mes dt. 14-15 Prill të vitit 2007, ka shkuar në fshatin Peran në oborrin e shkollës fillore “A. H.” dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 10 metra, me dimensione 4x35, në vlerë rreth 150€, e cila e përçonte rrymën elektrike në shtëpinë e të dëmtuarit I. F. dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

II. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huajta të luajtshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në natën në mes dt. 14-15 Prill të vitit 2007, ka shkuar në fshatin O., në oborrin e të dëmtuarës -shkollës fillore “A. H.” dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 10metra, me dimensione 4x35, që e furnizonte shkollën me rrymë dhe një kablo tjetër me gjatësi rreth 10metra, me dimensione 3x2.5 e cila e furnizonte motorin e ujit me rrymë që të dyja në vlerë rreth 300€ dhe është larguar nga vendi i ngjarjes

III. Me qëllim që me përvetësimin sendeve të huajta të luajshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në orët e vona të mesnatës të dt. 16.04.2007, ka shkuar në fshatin O. afër shtëpisë së të dëmtuarit F.Z., dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 10 metra , me dimensione 4x20, në vlerë rreth 120 €, e cila e përçonte rrymën elektrike nga shtylla deri në tokë në drejtim të shtëpisë së të dëmtuarit dhe është larguar nga vendi i ngjarjes,-

IV. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huajta të luajshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në orët e vona të natës të dt.16.04.2007, ka shkuar në fshatin O. afër shtëpisë së të dëmtuarit M. H., dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 40metra, me dimensione 4x6mm, e cila e përçonte rrymën elektrike nga shtylla deri në shtëpinë e të dëmtuarit dhe një gyp të aluminit me gjatësi rreth 6 metra, që të gjitha në vlerë rreth 170 €, dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

V. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në orët e vona të natës dt. 16.04.2007, ka shkuar në fshatin O. afër shtëpisë së të dëmtuarit Z. H., dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 8 metra, me dimensione 4x8 e cila e përçonte rrymën elektrike nga shtylla deri në shtëpinë e të dëmtuarit dhe një gyp të aluminit me gjatësi rreth 6 metra, që të gjitha në vlerë rreth 300€ dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

VI. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në natën në mes të dt. 15-16 Prill të vitit 2007, ka shkuar në fshatin O., në afërsi të shtëpisë së të dëmtuarit F. D., dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 10metra, me dimensione 5x35, në vlerë rreth 1000 €, dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

VII. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaj të luajshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm i pandehuri në natën në mes dt. 15-16 Prill të vitit 2007, ka shkuar në fshatin Llapashticë e epërme, në oborrin e të dëmtuarës-shkollës fillore “N. V.” dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalikë është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm dana dhe sharrë për prerje të metalit ka prerë kabllon elektrike në gjatësi prej 7 metra, që e përçonte rrymën nga shtylla elektrike deri në tokë e pastaj në shkollë, duke i shkaktuar të dëmtuarës dëm në vlerë rreth 210€ dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

VIII. Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajshme vetit ti sjell përfitim pasuror të kundërligjshëm, i pandehuri në natën në mes dt. 17-18 gusht të vitit 2006, ka shkuar në fshatin Peran, në afërsi të shtëpisë së të dëmtuarit A.I. dhe me kalimin e pengesave duke i përdorur shkallët metalike është ngjitur në shtyllë elektrike dhe me përdorimin e forcës me mjet të përshtatshëm të pidentifikuar ka prerë dy kabllon elektrike që të dyja në gjatësi prej 100 metra, në vlerë rreth 110 € dhe është larguar nga vendi i ngjarjes.

-Me këtë në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së

Andaj, gjykata në bazë të neneve 3,11,15,34,36,38,60,64,të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365,370,450, 453,463, të KPPPK-së ,e

G J Y K O N

Të akuzuarin **B. (S.) U.**, me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, dënim ky të cilin do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën aq sa bëhen sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate ndërsa në emër të shpenzimeve paushalle të paguaj shumën prej **150€ (njëqindpesëdhjetë/euro)**, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 60 të KPK-së, konfiskohet teli pasi që ishte objekt i kryerjes së veprës penale.

Të dëmtuarit: I. F., F. Z., M.H., Z. H. që të gjithë nga fshati O. KK.P., A. I. nga fshati P., përfaqësuesi i shkollës "A. H." në fshatin O. dhe P. dhe përfaqësuesi i shkollës "N. V.i" nga fshati Ll. E. KK.P., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Ndërsa për të miturin G. F. i biri I. dhe nënës B., e gjinisë H., i lindur me *data e lindjes...*, nga P. rruga "... " pn, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 363 par.1 pika1.3 të KPPRK-së,

REFUZOHET AKUZA

Me datë 15.04.2007 dhe 17.04.2007, në deponin për grumbullimin e hekurinave "Te Rr.F." në fshatin Sh., i mituri ka blerë nga i pandehuri B. U. një herë 12 kg. bakër, në shumë prej 36€ dhe herën tjetër 15kg bakër, në shumë-prej 45 €, edhe pse e ka ditur se sendi i të cilin e ka blerë është i përfituar me kryerjen e veprës penale.

Me këtë në vazhdimësi kishte për të kryer veprën penale Pranimi i mallrave të vjedhura nga neni 272 par. 1 të KPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale sa i përket të pandehurit G. F. bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës

A r s y e t i m

PPK në Prishtinë - tani Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP.nr.1693-12/2007, të datës 05.11.2008, kundër të akuzuarit B. U. për shkak të veprave penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së, dhe Propozim për Shqiptimin e Masës Edukuese Mbikëqyrja e Shtuar nga Organi i Kujdestarisë PPM.nr.184-12/2007, të datës 05.11.2008, ndaj të miturit G. F., për shkak se në vazhdimësi ka kryer veprën penale pranimi i mallrave të vjedhura 272 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti shqyrtimet gjyqësor në praninë e prokurorit të Shtetit, të dëmtuarve dhe të akuzuarit.

Gjykata lidhur me të miturin G. F., për shkak të veprës penale pranimit i mallrave të vjedhura nga neni 272 par.1 të KPK-së, në seancën e datës 04.08.2015, me aktvendim ka konstatuar se ka arritur parashkrim absolut me datë 17.04.2011.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i akuzuari B. U. u deklarua i pa fajshëm për veprën penale për të cilën akuzohet.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare deklaroi, nga provat e siguruara dhe të administruara gjatë shqyrtimeve gjyqësore është vërtetuar çështja faktike si në dispozitivin e aktakuzës. I propozoj Gjykatës që t'ua falë besimin dhe të njëjtin ta shpallë përgjegjës për veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së, dhe me rastin marrjes së dënimit t'i merr rrethanat si ato lehtësues dhe ato rënduese.

Gjykata gjatë procedurës se provave ka dëgjuar, të dëmtuarit: I. F., F. Z., M. H., dëshmitarin S. F., K. R. dhe G. F., dhe janë lexuar: Vërtetimi mbi marrjen e sendeve të datës 19.04.2007, foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes si dhe deklarata e të akuzuarit dhënë me datë 26.04.2007 në Stacionin Policor në Podujevë, dhe është dëgjuar mbrojtja e të akuzuarit. Të gjitha këto me qëllim të vërtetimit të plot dhe të drejt të gjendjes faktike.

Në shqyrtimin gjyqësor publik në këtë çështje penale këto prova gjykata konform nenit 8 dhe nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet dhe provat e lartcekura në shqyrtim gjyqësor që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje përkushtim maksimal e profesional dhe me ndërgjegjeje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, ka nxjerrë përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara.

Kjo gjykatë konsideron se përtej çdo dyshimi pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Dëshmitari I. F. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash deklaroi: Me datë 15 prill 2007, kur jam zgjuar në mëngjes nuk ka pasur rrymë në shtëpi, deri ka ora 1 nuk kamë ditur se ka ndonjë defekt, më pastaj i ftova dy elektrikistë e kontrolluan orën dhe shkuam te shtylla elektrike dhe e pamë se kablla ishte e prerë dhe marrë diku përafërsisht 10 metra, në vlerë prej 150 euro.

Dëshmitari F. Z. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash deklaroi: Me datë 16-17 prill 2007, diku rreth orës 12-01 të natës u ndal rryma, dolëm te disa axhallar dhe pamë se tek ata kishte rrymë, shkuam e shikuam menjëherë tek shtylla elektrike dhe e vërejtëm se kabllo ishte e këputur, përafërsisht e gjatë rreth 10 metra në vlerë prej 120 euro.

Dëshmitari M. H. në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash deklaroi: Me datë 16 prill 2007, në mëngjes nuk ka pasur rrymë, kur kam dalë në oborr mixha Z. më tregoi se kabllo nuk është në shtyllë elektrike, dhe ka shtuar duku rreth 10 metra dhe një gyp i aluminit prej 6 metrave që më është shkaktuar dëm rreth 200 euro.

Nga Dëshmia e zyrtarit policor S. F. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor veç tjerash deklaroi, se para marrjes në pyetje të dyshuarit i janë treguar të gjitha të drejtat ligjore sipas kodit të procedurës penale, për çka ka qenë i njoftuar edhe prindi i tij, dhe pas deklarimit është nënshkruar procesverbali, është intervistuar dy herë për shkak se B. U., në deklaratën e parë ka deklaruar se kabllon nuk e ka vjedhur, por i kan dhënë dy shokë të tij të fshatit A. H. dhe A. H.1, të cilët e kanë mohuar kryerjen e veprave penale, dhe arsye tjetër ka qenë pasi që kishim një informatë anonime se B. U. pasi i ka prerë kabllo të ka djegur afër shtëpisë së tij në një arë. Njësitë i Hetimeve

në përbërje të S.F., zyrtari Policor i forenzikës R.F. dhe zyrtari policor H. K. kemi shkuar në drejtim të shtëpisë së B. U. për ta gjetur lokacionin se ku është djegur kablla, para se të arrijmë te shtëpia e kemi takuar B. në rrugë, ka kërkuar që të vijë me ne dhe ka treguar lokacionin e saktë se ku e ka djegur kabllon gjë që është fotografuar nga polici i fornzikës, e më pastaj është ftuar që të vijë në Stacion Policor për tu intervistuar pa presion dhe me vullnetin e tij, i janë lexuar të drejtat prapë, ka refuzuar prezencën e mbrojtësit dhe e ka pohuar në tërësi kryerjen e veprave penale.

Nga dëshmia e zyrtarit Policor K. R. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit veç tjerash në shqyrtimin gjyqësor deklaroi, kam qenë i angazhuar në rastin e hetimit të vjedhjes me nr. të rastit 2007-AF-0510, që ka ndodhur në fshatin Ll. në Objektivin e Shkollës “N. V.” dhe kam marrë pjesë në intervistim për të dyshuarin B. U. së bashku me kolegun S. F., para marrjes në pyetje i janë lexuar të gjitha të drejtat, i njëjti ka refuzuar të ketë mbrojtës të cilën deklarata e ka nënshkruar në fillim të procesverbalit dhe në fund me vullnetin e tij.

Nga dëshmia e G. F. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor deklaroi se me datë 17.04.2007, kamë blerë bakër nga B. U., pasi që kamë punuar dhe punoj në deponi të mixhës, duke mos e ditur se është e vjedhur për shkak se ka qenë i djegur.

Nga lista e provave materiale të datës 19.04.2007, vërtetohet se nga G. F., zyrtarët policor kanë sekuestrua telin e rrymës së djegur, që e kishte blerë nga B. U., e që ishte objekti kryerjes së veprës penale.

Nga foto-dokumentacioni në shkresat e lëndës, vërtetohet vendi ku është djegur teli i rrymës, duke e treguar vendin vetë i akuzuari B. U..

Nga procesverbali i marrjes në pyetje të akuzuarit B. U., në Stacionin Policor në Podujevë të datës 26.04.2007, vërtetohet se i akuzuari në tërësi i kishte pranuar kryerjen e veprave penale dhe në mënyrë të hollësishme kishte shpjeguar mënyrën e kryerjes së veprave penale në tërësi si në dispozitivin e këtij aktgjykimit.

I akuzuari në fjalën përfundimtare deklaroi se nuk e ndjen veten fajtor dhe kërkoj nga gjykata ta shpall të pa fajshëm për këto vepra penale nga se nuk i ka kryer.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, gjykata sipas bindjes së lirë vërtetoi gjendjen e plot dhe të drejt faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke ju dhënë besimin e plot dëshmitarëve, G. F., zyrtarëve Policor të dëgjuar në cilësinë e dëshmitarëve, Listës së provave materiale 19.04.2007, foto dokumentacionit, deklaratës së vetë të akuzuarit dhënë në polici, e të cilat ndërlihdeshin njëra me tjetrën se i akuzuari ka kryer në vazhdimësi veprat penale si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se i akuzuari i ka kryer veprat penale me dashje, me paramendim sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe ka dashur kryerjen e veprave penale.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqitur rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të akuzuarit, kështu që gjykata gjeti se i njëjti është penalisht përgjegjës.

Gjykata e ka analizuar mbrojtjen e të akuzuarit duke gjetur se është e drejtuar nga ikja e përgjegjësisë penale duke e hedhur poshtë si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara nga të cilat u vërtetua përtej çdo dyshimi gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata duke mos u detyruar me propozimin e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 360 par. 2 të KPPRK-së, ka konstatuar se i akuzuari në vazhdimësi ka kryer veprat penale vjedhje e rëndë nga neni 253 par. 1 pika 1 të KPK-së, pasi që janë kryer më shumë se dy vepra penale, janë të llojit të njëjtë, i ka kryer i njëjti person të gjitha veprat penale, të gjitha veprat penale janë kryer brenda periudhës së shkurt kohore, dhe të gjitha këtë vepra penale janë kryer me dashje.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar nga provat e administruara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të akuzuarit B. U. përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale në vazhdimësi vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 pika 1 të KPK-së.

Gjykata lidhur me të pandehurin G. F. për veprën penale pranim i mallrave të vjedhura nga 272 par. 1 të KPK-së, ka vërtetuar se nga koha e kryerjes së veprës penale 15.04.2007 dhe 17.04.2007 ka arritur parashkrimi absolut me datë **17.04.2011**, ashtu që ligjvënësi në kuptim të nenit 90 par. 1 nën par.6 të KPK-së, ka përcaktuar se parashkrimi i ndjekës penale është dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri në një vit burgim ose dënim me gjobë, ndërsa neni 91 par.6 të KPK-së, ka paraparë se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), andaj, gjykata vendosi me aktgjykim refuzues të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPRK-së.

Me rastin vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 64 të KPK-së, dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti se ishte korrekt gjatë shqyrtimit gjyqësor, më parë i gjykuar, në kohën e kryerjes së veprës penale ishte i moshës së re, duke e marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale si rrethana veçanërisht rënduese gjykata gjeti se i njëjti ka qenë i gjykuar edhe më par për vepra penale vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, sipas aktgjykimit që mban shenjën P.nr.176/07, si dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur që është prona private dhe ajo shoqërore, të dëmtuara dy shkolla fillore, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, andaj gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të cilin dënim do ta mbaj pasi aktgjykim të merr formën e prerë.

Ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që të parandaloj nga kryerja e veprave penale, të parapara me nenin 34 të KPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marr në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi konfiskimin e telit është marr konform nenit 60 të KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 363, dhe 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZONI PENAL**

P.nr.1101/12,dt.21.12.2015

**Sekretarja Juridike
Mihrie Krasniqi-Sheholli**

**Gjyqtari i vetëm gjykues
Gazmend Bahtiri**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.